

**Tabela për Konsultimin Publik të Projektligjit
“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”**

Titulli i projekt-aktit	Afati i paraqitjes në KM	Objektivi/Qëllimi	Peridha e konsultimit publik	Mënyra e konsultimit publik	Komente
Projektligj “Për mbrojtjen sociale në Republikën e Shqipërisë”	Katërmujori I i vitit 2019	Qëllimi i projektligjit është: 1. Të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. 2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre. 3. Të garantojë mbrojtje sociale nëpërmjet mbështetjes	Sipas Parashikimeve Ligjore të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.	1. Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. http://shendetesia.gov.al/6-konsultime-mbi-projektligje/ 2. Projektligji u diskutua në datën 09 Janar 2019 në tryezën me organizata të shoqërisë civile, ku morën pjesë edhe përfaqësues të Avokatit të Popullit. Në këtë tryezë morën pjesë, Znj. Ardiana Jaku Zv/Ministre; Znj. Bardhylka Kospiri, Zv/Ministre; Znj.	Në tryezën e konsultimit u prezantua projektligji dhe risitë që sjell. u sugjeruan dhe u reflektuan komente që kanë të bëjnë me: - Titullin e projektligjit duke zëvendësuar termin “Mbrojtje Sociale” me “Asistencë sociale”, pasi mbrojtja sociale përfshin një gamë më të gjërë shërbimesh sociale. - Zëvendësimin e përkufizimit të aftësisë së kufizuar sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”. - Rishikimin e parimeve të ligjit dhe shpjegimi i tyre sipas konventave. - Përkufizimin e përfitimeve në pagesa dhe natyrë dhe shtjellimin e disa termave të përdorur në projektligj. - Shtimin e disa detyrave pushtetit vendor të cilat kanë të bëjnë me informimin e publikut, bashkërendimin e informacionit me njësi të tjera të vetqeverisjes vendore dhe referimin e përfituesve edhe në shërbime të tjera përmes bashkëpunimit me struktura të tjera që ofrojnë shërbime sociale, shëndetësore, të arsimit,

		financiare për nënat me foshnjat e porsalindura. Objektivi i përcaktimit të së drejtës për mbrojtje sociale të grupeve në nevojë, por jo vetëm, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin dhe garantimin e kësaj të drejte, si edhe marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të mbrojtjes sociale.	Merita Xhafaj, Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Znj. Denada Seferi Drejtore e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe stafi i Sektorit të Programeve të Pagesave të Aftësisë së Kufizuar dhe Ndihmës Ekonomike. 3. Projektligji është diskutuar në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore dhe Vetqeverisjes Vendore në muajt Dhjetor 2018 dhe Prill 2019. Përmes këtij këshilli i është	punësimit, strehimit, etj. - Rishikimin e afateve të ankimimit, duke i dhënë më shumë kohë qytetarit për të ushtruar këtë të drejtë. - Saktësimin e disa termave të përdorur dhe riformulim frazash/fjalishë duke përdorur një gjuhë më të drejtpërdrejtë e të kuptueshme. - Përcaktimin e afateve në dispozitat kalimtare dhe dispozitën për aktet nënligjore. - Përcaktimin e dispozitave në ligjet referuese, apo përdorimin e përkufizimit të plotë të marrë nga ligji referues. - Përfshirjen e familjeve me më shumë se dy deklarime të rreme në rastet që duhet të penalizohen me përjashtim nga skema e ndihmës ekonomike, me argumentin se kërkojnë të përfitojnë padrejtësisht përmes mashtrimit në mënyrë të përsëritur. Nuk reflektohen komentet për arsytet e mëposhtme: - Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në llogaritjen e masës së ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes. Nuk reflektohet ky koment për shkak se nga i njëjti program buxhetor “Përkujdesi Social” përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar dhe se ky sugjerim nuk shoqërohet me asnjë argument bindës. - Komentet të cilat kanë të bëjnë me çështje të cilat rregullohen me akte nënligjore, të tilla si përcaktimi i masave të pagesave për arsimimin e personave me aftësi të
--	--	--	--	---

				dërguar të gjitha Bashkive për mendim.	kufizuar, të cilat synohen që në vijim të transferohen gradualisht në legjislacionin e arsimit në kuadër të reformës, me qëllim që të merret në natyrë përmes bursave apo formave të tjera të mbështetjes. - Komenti për parashikimin e vetëm një forme të vlerësimit të aftësisë së kufizuar pasi reforma e vlerësimit bio-psiko-social do të shtrihet në mënyrë progresive dhe skema ekzistuese e vlerësimit nuk mund të mbetet e parregulluar me ligj, pasi do të shkaktonte <i>Gap</i> ligjor. - Heqja e kufizimit që Këshilli Bashkiak ka për të marrë vendim për trajtimin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, vetëm për familjet aplikuese në sistem për përfitimin e ndihmës ekonomike, pasi këto raste mund të trajtohen nga fondet e vetë Bashkive. - Çështja e garantimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore për ndihmësit personalë, pasi është çështje do të rregullohet me akte nënligjore. - Komenti se projektligji ka mungesë totale të një neni, perkufizimesh të ndërhyrjeve dhe diagnostikimit në moshë të herëshme, për shkak se parandalimi dhe ndërhyrja e hershme janë procese që i paraprijnë vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe rregullohen me ligje sektoriale në fushën e shëndetësisë dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror. - Komenti për heqjen e kufizimit "...pas daljes nga institucionet...", për viktimat e
--	--	--	--	---	--

					trafikimit, për shkak se këto përfitime garantohen në bazë të VKM nr. 114, datë 31.01.2007 të ndryshuar, gjatë qëndrimit në institucion. - Komenti për lenien evazive dhe pa një përcaktim të kushteve të përfitimit të ndihmës personal pasi të gjitha këto grupe të aftësisë së kufizuar të cilat kanë të drejtë për kujdestarë përfshihen në pikat 2 dhe 3 të nenit 7. - Komenti për harmonizimin e nenit 16 me VKM nr. 431/2016, pasi komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar janë përcaktuar në nenin 7 të ligjit. - Përcaktimi i procedurave, për shkak se do të përcaktohen me akte nënligjore. - Komenti se qindra familje rome dhe egjiptiane janë përjashtuar nga sistemi për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve, mungesës së buxhetit dhe prioritarizimit në sistem. Sistemi nuk prioritetizon dhe nuk është subjektiv në përzgjedhje. Nuk është i argumentuar pretendimi për pamjaftueshmëri të fondeve. - Pretendimi i përjashtimit nga skema e ndihmës ekonomike të rasteve të shkeljeve të rënda të etikës në punë dhe zgjidhjes së kontratës nga punëdhësi në mënyrë të menjëhershme. Kur kontrata zgjidhet nga punëdhënësi familja nuk përjashtohet nga NE - Lidhur me komentin se ligji duhet të parashikojë transparencë më të madhe për
--	--	--	--	--	---

					sistemin e pikëzimit dhe llogaritjes së pikeve, sqarojmë se transparenca e formulës bëhet me VKM. - Nuk refletohen komente për ndryshimin e renditjes së neneve, por do të kihet në konsideratë gjatë reflektimit të mendimeve të Ministrisë së Drejtësisë e cila është kompetente për tu shprehur mbi teknikën legislative dhe nëse do të ketë përputhje do të përfshihen në një fazë tjetër. - Lidhur me komentin se në ligj nuk dalin rregullime të përfitimeve në natyrë, sqarojmë se këto rregullime gjenden në nenin 11, pika 2 e tij. - Komenti për të përdorur përkufizimin e INSTAT mbi “Njësinë ekonomike familjare” për termin “familje” nuk qëndron, pasi nuk përputhet. - Shtimi i personave të verbër në kategoritë që përjashtohen nga përfitimi nuk reflektohet, pasi për atë kohë sa nuk përmenden në nenin e kategorive përfituese, do të thotë që nuk përfitojnë nga ky ligj pasi trajtohen me ligj të vecantë. - Komenti se mbështetja me pagesa për nxitjen e vaksinimit të fëmijëve është e tepërt, nuk pranohet. - Komenti për periudhën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar krahas pagës, do të rregullohet dhe detajohet me akte nënligjore. - Komenti se për moshat e rritura, deklarimi i remitançave cënon parimin e dinjitetit/personalitetit njerëzor , nuk
--	--	--	--	--	--

					qëndron sepse sipas Bankës së Shqipërisë remitancat janë pjesë përbërëse në identitetin e llogaritjes së të ardhurave të disponueshme. - Lidhur me komentin se cila strukturë e bashkisë ekzekuton pagesat, mendojmë që është e tepërt për tu specifikuar sektori përkatës, për sa kohë që përmendet institucioni (Bashkia). - Lidhur me komentin se ka kontradiktë mes neneve 21 dhe 22 të ligjit, nuk qëndron. - Lidhur me komentin se ankimimi për personat me aftësi të kufizuar nuk garantohet nga dispozita e ankimimit, sqarojmë se procedura e ankimimit për vendimin e marrë nga KMCAP e nivelit të parë në KMCAP Epror realizohet në bazë të legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe VKM-së përkatëse për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Epror. - Komenti për ndryshimin e pikës 2/d të nenit 14 si masë e ashpër dhe penalizuese për kategori që nuk janë në gjendje të njohin dhe respektojnë afatet ligjore dhe sugjerimi se në këtë rast duhet rritur roli proaktiv i administratorit shoqëror për të marrë kontakt fizik dhe nxituar përfituesit për deklarinimin e ndryshimeve të situatës së tyre ekonomike, nuk reflektohet për shkak se, familjet përfituese përveç të drejtave kanë edhe detyrime për të siguruar qëndrueshmërinë në skemën e NE-së. Nga konsultimi me bashkitë rezulton se:
--	--	--	--	--	---

					- janë shprehur dakord me përmes postës elektronike 9 bashki (bashkitë Maliq, Pustec, Kolonje, Permet, Belsh, Cerrik, Tepelene, Divjake, Devoll). - nuk kanë kthyer përgjigje 22 bashki (bashkitë Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Has, Kukës, Tropojë, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Shkodër, Finiq, Konispol, Vlorë, Kuçovë, Dibër, Klos, Peqin, Lushnjë, Kavajë dhe Rrogozhinë). Lidhur me komentën e AMVV për rritje të fondit deleguar bashkive sqarojmë se fondi është 2-fishuar (nga 3% që ishte me skemën e mëparëshme në 6%). Bashkitë kanë të drejtë ta plotësojnë këtë fond me fondet e veta. Për sa i përket kërkesës për përcaktimin e kufirit minimal të detyrueshëm për financimin e programeve të mbrojtjes sociale, këto fonde jepen sipas buxhetit të miratuar çdo vit për këtë zë. Lidhur me komentën për aplikimin e punëve në komunitet në vend të ndihmës ekonomike sqarojmë se kjo do të jetë pjesë e një strategjie daljeje nga skema e NE-së. Lidhur me vendosjen e disa dispozitave për regjistrimin e popullsisë apo strehimit, sqarojmë se këto rregullohen me legjislacionin e fushës dhe përsëritja mund të shkaktojë mbivendosje.
--	--	--	--	--	--

					Refuzohen kërkesat për rishikimin e afateve të penalizimeve në rastin e mashtrimit në skemën e NE-së pasi kjo do të rriste abuzivitetin në këtë skemë. Është reflektuar komenti për rishikimin e pikës 5 të nenit 20 të projektligjit. Nuk janë reflektuar kërkesa të disa bashkive të cilat nuk kanë të bëjnë me përcaktime në legjislacion, pasi janë çështje konfigurimin në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike. Lidhur me komentin që përfituesit e fondit 6% duhet të marrin të gjitha përfitimet sikundër përfituesit e NE-së sqarojmë se kjo është një e drejtë tashmë e garantuar për të gjithë përfituesit, por që nuk ka gjetur zbatim korrekt nga ana e disa bashkive, pasi legjislacioni nuk diskriminon apo trajton në mënyrë të pabarabartë asnjë kategori. Lidhur me përfshirjen e të verbërve në kategoritë përfituese sqarojmë se me skemën aktuale trajtohen me ligj të vecantë, ndërsa me skemën e reformuar të aftësisë së kufizuar do të përfshihen brenda kategorisë PAK. Lidhur me limitimin e moshës për punë sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë për punë sqarojmë se mosha për punë rregullohet me akte të tjera ligjore, ndërsa aftësia për
--	--	--	--	--	---

					punë përcaktohet nga strukturat kompetente sipas përcaktimeve ligjore dhe kriterëve mjekësore. Komentet të cilat lidhen me rregullime që bëhen me akte nënligjore do të reflektohen gjatë rishikimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligj. Ligji nuk pengon reflektimin e tyre në aktet nënligjore. Nuk pranohet komenti për heqjen e shkallës së ankimimit pranë pushtetit vendor për shkak se individit ka të drejtë edhe për çështje të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me vendimmarrjen, të tilla si procedura e aplikimit, njoftimit, ekzekutimi i pagesave, etj të cilat kryhen nga pushteti lokal. Është reflektuar komenti për riformulimin e konceptit (riintegrim social). Nuk janë reflektuar komente për përfshirje të dispozitave që rregullojnë shërbimet e kujdesit social, pasi kjo fushë rregullohet me ligj të vecantë 121/2016 Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH. Është reflektuar komenti për përfitimin e bonusit të bebes nga kujdestari ligjor në mungesë të nënës. Lidhur me komentin për përcaktimin e minimumit jetik me këtë ligj sqarojmë se përcaktimi i tij kërkon kryerjen e një
--	--	--	--	--	--

					studimi shkencor dhe anketimi të gjerë që përfshin të dhëna ndërsektoriale statistikore dhe financiare mbi të ardhurat, pagën minimale, punësimin, sigurimet shoqërore, indekset e çmimeve, të dhënat e buxheteve familjare që disponon INSTAT, inflacionin, nevojat e popullsisë për artikuj ushqimorë dhe shpenzime për mbrojtjen sociale, sigurime shëndetësore, etj. Lidhur me komentin e përcaktimit të formulës së unifikuar të pikëzimit me ligj sqarojmë se kjo formulë përcaktohet me VKM pasi mund të përditësohet në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend. Ndryshimet ligjore kërkojnë më shumë kohë. Komenti për reduktimin e verifikimeve në familje nga 2 herë në vit në 1 herë në vit, nuk pranohet për shkak se këto verifikime mundësojnë mbajtjen e skemës nën kontroll dhe shmangjen e abuzivitetit në përfitimin e ndihmës ekonomike. Lidhur me pretendimin se pagesa e viktimave të dhunës përfitohet gjatë sistemit në strehëz sqarojmë se pagesa e NE për viktimat e dhunës nuk lidhet me vendosjen në institucion por me UM ose UMM. Krahs pagesës së NE-së viktimat e dhunës që sistemohen në strehëz përfitojnë edhe pagesën shtesë prej 3,000 lekë gjatë qëndrimit në strehëz.
--	--	--	--	--	--

					Vërehen komente që nuk i referohen këtij ligji, por ligjit Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ligjit Për shërbimet e kujdesit social në RSH, për këtë arsye nuk reflektohen. Janë reflektuar komentet për moskalimin për miratim në Këshill Bashkiak të aplikuesve të NE-së dhe përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar. Kërkesa për heqjen e detyrimit për paraqitje të antarëve madhorë pranë administratorit cdo tre muaj do të rriste rastet e përfitimit të padrejtë kur anëtarë të familjes mund të kenë emigruar. Me skemën e mëparëshme detyrimi i paraqitjes ishte i përmuajshëm dhe tashmë është lehtësuar me skemën e re. Kërkesa e disa bashkive për hapje të zyrave vendore të punës pranë bashkive që nuk kanë zyrapune do të adresohet pranë strukturave përgjegjëse.
--	--	--	--	--	---